



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS  
REKTORATI**

Nr. 3258 Prot

Tiranë, 25.10.2024

**MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI**

Sot, më datë 25.10.2024, lidhet kjo Marrëveshje Bashkëpunimi midis Palëve si më poshtë:

**Universitetit Bujqësor të Tiranës**, qendra më e rëndësishme e formimit universitar, pasuniversitar, kërkimit shkencor, trajnimit dhe ekstensionit në fushën e Bujqësisë, Blegtorisë, Mjedisit, Ushqimit dhe Pyjeve, me adresë “Kodër-Kamëz, Tiranë”, përfaqësuar nga Rektori i Universitetit Bujqësor të Tiranës, **Prof. Dr. Fatbardh SALLAKU**, në cilësinë e Autoritetit më të lartë akademik të Universitetit Bujqësor të Tiranës, si dhe përfaqësuesi ligjor i tij për çështjet akademike dhe protokollare , **më poshtë referuar si UBT**

**dhe**

**SINAMATI SHPK** , regjistruar me numer nipti **M41310007S**, me adresë, **Tiranë, Rr. Nexho Homoni** përfaqësuar nga administratori **Znj. Tea Sinamati** identifikuar me letërnjoftimin ID me nr. **J45926045S..**

Në funksion të nevojave për zhvillimin e procesit mësimor, sidomos të formimit praktik profesional të studentëve, si dhe realizimin e programit kërkimor e shkencor në fushat e Mjedisit , transferimit të njohurive, teknologjisë dhe afimit të shërbimeve për sipërmarrjen

Adresa: Rruga “Paisi Vodica, Kodër-Kamëz, Tiranë, [eëë.ubt.edu.al](http://eëë.ubt.edu.al)

private, rritjes së angazhimit dhe aktiviteteve në këto fusha në ndihmë të komunitetit në vendin tonë, palët,

## **BIEN DAKORD**

Të lidhin këtë marrëveshje bashkëpunimi dhe të angazhohen si më poshtë:

### **NENI 1**

#### **QËLLIMI I MARRËVESHJES**

Qëllimi i kësaj marrëveshje është në kuadër të bashkëpunimit dhe angazhimit të palëve në funksion të nevojave për zhvillimin e procesit mësimor, kryesisht të formimit praktik profesional të studentëve, si dhe realizimin e programit kërkimor e shkencor në fushat e vlerësimi të mjedisit dhe, transferimit të njohurive, teknologjisë dhe afrimit të shërbimeve për sipërmarrjen private në bujqësi , rritjes së angazhimit dhe aktiviteteve në këto fusha në mënyrë që t'i vihet në ndihmë komunitetit në vendin tonë.

### **NENI 2**

#### **BAZA LIGJORE**

Kjo marrëveshje bashkëpunimi hartohet në bazë të Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 1, neni 3, neni 39, pika 1 dhe Statutit të Universitetit Bujqësor të Tiranës, miratuar me urdhër ministri me nr. 279, datë 28.07.2021, neni 2, pika 6, gërma o, neni 3, neni 23, pika 1.

### **NENI 3**

#### **OBJEKTI I MARRËVESHJES**

Kjo marrëveshje bashkëpunimi ka për objekt rregullimin e marrëdhënies juridike mes palëve, përcaktimin e rregullave dhe modaliteteve brenda të cilave Palët do të zhvillojnë marrëdhëniet ndërmjet tyre për arritjen e objektivave të përbashkët.

### **NENI 4**

#### **AFATI I MARRËVESHJES**

---

Adresa: Rruga “Paisi Vodica, Kodër-Kamëz, Tiranë, [ubt.edu.al](http://ubt.edu.al)



Kjo marrëveshje lidhet për një kohëzgjatje pa afat të caktuar.

## NENI 5

### FORMAT DHE MËNYRAT E BASHKËPUNIMIT

- a) Palët njihen paraprakisht me faktin se kjo marrëveshje nuk është një kontratë, por përbën një dokument kuadër sipas të cilit palët deklarojnë, në parim, vullnetin e tyre të lirë për një bashkëpunim në realizimin e projekteve dhe aktiviteteve të përbashkëta të praktikave profesionale të studentëve, kërkimit shkencor, transferimit të njohurive, teknologjisë, trajnimeve dhe afrimit të shërbimeve në fushën e Mjedisit.
- b) Palët janë të vetëdijshme se çdo bashkëpunim i mundshëm në të ardhmen do të jetë subjekt i protokolleve dhe kontratave të veçanta, të cilat do të rregullojnë në mënyrë specifike detajet e bashkëpunimit në fjalë.
- c) UBT, si një institucion publik i arsimit të lartë, i bën të njohur këtë marrëveshje, Ministrive Përgjegjëse për arsimin e lartë, bujqësinë e zhvillimin rural, mjedisin, financat, ekonominë, sipërmarrjen, punën dhe çështjet sociale, si dhe të gjithë agjencive qendrore dhe inspektoriateve përgjegjëse për zhvillimin bujqësor e rural, këshillimin në bujqësi, mbrojtjen e shëndetit dhe mirëqenies së kafshëve, sigurinë ushqimore, mjedisin, pyjet, tatimet, punën dhe punësimin, formimin profesional si dhe sigurimet shoqërore.

## NENI 6

### TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PALËVE

Palët në bashkëpunim me njëra-tjetrën, dhe në masën që nuk çënon ndërsjelltas interesat dhe aktivitetet e tyre:

1. Mirëpresin dhe marrin përsipër zhvillimin e praktikave profesionale në kompani/fermë (Duale) të studentëve të programeve Bachelor dhe Master në fushën Mjedisit.
2. Mirëpresin dhe marrin përsipër organizimin e vizitave të shkurtëra të studentëve, si edhe të stafit akademik dhe mbështetës së UBT, në **SINAMATI SHPK** si dhe të



specialistëve të kësaj të fundit në UBT, me qëllim realizimin e programeve/projekteve të përbashkëta dhe me interes të ndërsjelltë.

3. Shprehin gadishmërinë që të bashkëpunojnë ndërmjet tyre për realizimin e shërbimeve, ofrimin e ekspertizës, konsulencës shkencore, si dhe pjesëmarrjen e palëve në aktivitete të përbashkëta promovionale.
4. Në mënyrë më specifike, **kompania SINAMATI SHPK** do të demonstrojë preferencën e vet për të rekrutuar punonjës të rinj të diplomuar në fakultetet e UBT, ndërsa UBT merr përsipër organizimin e kurseve/trainimeve për punonjësit e kompanisë **SINAMATI SHPK**
5. Me qëllim njohjen dhe vlerësimin e ndihmesës së rëndësishme që i afron kompania **SINAMATI SHPK** UBT-së, për përgatitjen e studentëve dhe specialistëve të rinj të mjedisit, si dhe të kërkimit shkencor e transferimit të njohurive në fushën e mjedisit, UBT e shpall atë, përmes një certifikatë, anëtar i **“Forumi i Sipërmarrjeve Partnere të UBT”** dhe e përfshin në listën **“Fermat & Kompanitë Partnere të UBT-së”**. Ferma/kompania ka të drejtë ta bëjë publike këtë certifikatë në mjetet e komunikimit publik dhe ta vendosë atë në mjediset e veprimtarisë së saj.

## NENI 7

### KOORDINIMI NDËRMJET PALËVE

Secila prej palëve do të caktojë një person kontakti përgjegjës për mbarëvajtjen e marrëveshjes, me qëllim koordinimin e veprimtarive për realizimin e saj.

## NENI 8

### INTERPRETIMET

Palët do të interpretojnë çdo pikë të kësaj marrëveshje duke marrë parasysh vullnetin dhe dëshirën e mire që i ka sjellë palët deri në nënshkrimin e saj.

Kjo marrëveshje bashkëpunimi mes palëve, nuk mund të jetë pjesë e ndonjë konflikti gjyqësor dhe palët bien dakord që çdo keqkuptim që mund të lindë nga interpretimi i saj do ta zgjidhin me mirëkuptim dhe ndërmjetësim.



**NENI 9**

**DISPOZITA TË FUNDIT**

Çdo palë mund të kërkojë zgjidhjen e marrëveshjes, duke njoftuar me shkrim palën tjetër 6 (gjashtë) muaj përpara.

Të dyja palët mund të rishikojnë marrëveshjen duke ndërmarrë veprimet e duhura. Të gjitha ndryshimet duhet të bëhen me shkrim dhe duhet të miratohen zyrtarisht nga të dyja palët.

Palët në këtë marrëveshje bashkëpunimi do të bëjnë të gjitha përpjekjet për ekzekutimin sa më efektiv të të gjitha detyrimeve dhe angazhimeve të marra përsipër prej tyre.

***Kjo marrëveshje hyn në fuqi menjëherë nga data e nënshkrimit të saj nga palët.***

***Marrëveshja përpilohet gjuhën shqipe në 4 (katër) kopje me vlerë të njejtë ligjore ku secila palë merr 2 (dy) kopje prej tyre.***

**PËR:**

**KOMPANINW SINAMATI SHPK**

**PËR:**

**UNIVERSITETIN BUJQËSOR TË  
TIRANËS**

**ADMINISTRATOR**

**Tea Sinamati**



**Datë: .....**

**REKTORI**

**Prof. Dr. Fatbardh SALLAKU**



**Datë: 25/10/2024**